



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900540/17

Tiranë ___/___/2019

Lënda : Rekomandim për të bërë kërkesë padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier për përfutimin e të drejtës ligjore të kompensimit për burgim të padrejtë.

Drejtuar : Z. L.A.
Njësia Administrative Zharrës
Bashkia Roskovec

Zoti Asllani,

Në ankesën e bërë në Institucionin e Avokatit të Popullit në datën 12.04.2019 shkruani se jeni dënuar me 10 muaj burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe se ishit duke kryer dënimin penal në IEVP Fier. Ju pretendoni se jeni arrestuar në datën 18 Gusht 2018 dhe dënimin e keni mbaruar në datën 28 Mars 2019. Meqenëse po qëndronit padrejtësisht në burg, në datën 02.04.2019 i keni bërë një kërkesë drejtuar Gjykatës, por kjo gjykatë nuk e kishte gjykuar ende kërkesën tuaj.

Lidhur me këtë ankesë ju sqarojmë se:

Në bazë të kërkesës tonë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. 655 prot., datë 02.05.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se:

"Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 507, datë 19.11.2018 e ka dënuar shtetasin L.A. me 10 muaj burgim për kryerjen e veprës penale "Dhunë në familje", e parashikuar nga neni 130/a/4 të Kodit Penal. Vuajtja e dënimit fillon nga data e arrestimit, më 28.08.2018 dhe do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga ankuesi në datë 19.12.2018 dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit Vlorë me shkresën nr. 595 akti, datë 11.01.2019.

Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), nuk rezulton që nga ana e ankuesit të jetë depozituar kërkesë me objekt shuarjen e masës së dënimit apo ndonjë kërkesë tjetër, e cila të mos jetë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë".

Së bashku me shpjegimet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë na dërgoi edhe kopjen e vendimit nr. 507, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të shkresës përcjellëse të dosjes dërguar në Gjykatën e Apelit Vlorë, si dhe informacionin e printuar nga Sistemi ICMIS.

Mbi bazën e kërkesës tonë, IEVP Fier me shkresën nr. 2873/1 prot., datë 03.06.2019 na informoi se, ju jeni liruar nga burgju në datën 18.04.2019 në zbatim të urdhrin të ekzekutimit nr. 229, datë 18.04.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Sipas kësaj IEVP-je, lirimi juaj është bërë brenda ditës dhe menjëherë sapo kishte ardhur dokumentacioni përkatës nga organi i Prokurorisë, i cili është i ngarkuar nga ligji për të bërë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale me burgim. Bashkë me dokumentacionin IEVP Fier na dërgoi edhe fotokopjen e urdhrin të ekzekutimit nr. 229, datë 18.04.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe të urdhrin nr. 2012/1 prot., datë 18.04.2019, të Drejtorit të IEVP Fier për lirimin nga burgju të ankuesit.

Ndërkohë me kërkesën tonë, Gjykata e Apelit Vlorë na dërgoi kopjen e vendimit nr. 19, datë 27.02.2019 të dhënë nga kjo gjykatë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 507, datë 19.11.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila ju ka dënuar juve me 10 muaj burgim.

Nga vendimi gjyqësor rezulton ju jeni arrestuar në datën 28.08.2018 dhe jo në datën 18.08.2018, sikurse pretendoni në ankesën e bërë në institucionin tonë.

Në urdhrin e ekzekutimit nr. 229, datë 18.04.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë përshkruhet se:

*“... i dënuari L.A., nga dita e arrestimit në flagrancë të tij, datë 28.08.2018 dhe deri në ditën kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë formë të prerë (gjykimi në apel), datë 27.02.2019, ka qëndruar në paraburgim për një periudhë kohe prej 6 (gjashhtë) muaj heqje lirie në zbatim të masës së sigurimit personal “Arrest në burg” të marrë ndaj tij. Kjo kohëzgjatje e paraburgimit, sipas nenit 57 të Kodit Penal, llogaritet për efektet e masës së dënimit përfundimtar dhe është e barabartë me 9 (nëntë) muaj burgim. Shtetasi L.A. është dënuar përfundimisht me 10 (dhjetë) muaj burgim, **i mbetet akoma për të vuajtur 1 (një) muaj burgim**”*

Sipas këtij arsyetimi dhe nga përlllogaritja e bërë nga ana jonë rezulton se, ju duhet të liroheshit nga burgju në datën 26.03.2019 dhe jo në datën 18.04.2019, kur është nxjerrë ky urdher dhe që në fakt ju jeni liruar nga burgju (IEVP Fier). Pra, ju keni qëndruar në burg padrejtësisht për 23 (njëzet e tre) ditë, sepse urdhri i lirim tuaj nga organi i Prokurorisë është nxjerrë me vonesë.

Në vijim të shqyrtimit të këtij rasti dhe me kërkesën tonë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. 5973/1 prot., datë 25.06.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se:

“... Në datën 18.04.2019 është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë vendimi penal nr. 507, datë 19.11.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për të dënuarin L.A., me qëllim ekzekutimin e tij. Po atë ditë është nxjerrë urdhri i prokurorit nr. 229, datë 18.04.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për ekzekutimin e këtij vendimi dhe e gjithë praktika ekzekutuese është dërguar në institucionet përkatëse për zbatim, si dhe shtetasi L.A. për njoftimin e tij.

Sikurse shihet, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka marrë të gjitha masat dhe ka kryer të gjitha veprimet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilat nga ana tjetër shpjegojnë edhe faktin se qëndrimi i padrejtë në burg i shtetasi L.A. nuk ka ardhur nga vonesa e ekzekutimit të këtij vendimi nga Prokuroria, por nga dërgimi me vonesë nga ana e gjykatës. (Bashkëlidhur po ju dërgojmë të gjithë praktikën e ekzekutimit të vendimit penal).”

Duke e ballafaquar përgjigjen e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me dokumentat e bashkëlidhura asaj konstatoam se:

1. Në përgjigje nuk saktësohet se cila Gjykatë ia ka dërguar me vonesë vendimin penal nr. 507, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për të dënuarin L.A..

2. Nga shkresa përcjellëse nr. 217 prot., datë 15.04.2019 e Kancelarit të Gjykatës së Apelit Vlorë rezulton se Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë i është dërguar vendimi nr. 19, datë 27.02.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe jo vendimi penal nr. 507, datë 19.11.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë të dhënë ndaj jush sikurse shprehet ky organ.

3. Vendimi nr. 19, datë 27.02.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë është dërguar nga Kancelari i Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. 217 prot., datë 15.04.2019 dhe sipas shënimit të bërë në shkresën përcjellëse (në anën e djathtë sipër), ky vendim ka ardhur në organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në datën 17.04.2019 dhe jo në datën 18.04.2019 sikurse na thuhej në informacion. Pra, për një ditë burg që ju keni bërë më shumë ka përgjegjësi edhe organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Për këto arsye i kërkuam Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë të na dërgonte informacion shtesë lidhur me këto konstatime, dhe nëse kishte ndonjë shkresë të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, të na e dërgonte atë.

Në vijim të kësaj kërkesë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. 6351/1 prot., datë 03.07.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se:

“Në datën 17.04.2019 është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë vetëm vendimi nr. 19, datë 27.02.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka lënë në fuqi vendimin penal nr. 507, datë 19.11.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për të dënuarin L.A..

Pasi është sigluar nga drejtuesi i Prokurorisë, vendimi i apelit është përcjellë tek sekretaria për t’u dorëzuar në zyrën e ekzekutimit të vendimeve penale me qëllim ekzekutimin e tij. Sipas praktikës së ekzekutimit, prokurori i ekzekutimit të vendimeve penale është vënë në dijeni për këtë vendim në datën 18.04.2019 dhe meqënëse ka konstatuar se i dënuari L.A. e kishte vuajtur dënimin e dhënë deri në ato momente kur kishte mbërritur vendimi penal i Gjykatës së Apelit, është interesuar personalisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë dhe ka tërhequr dorazi vendimin penal nr. 507, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë pa lejuar vonesa të tjera duke pritur me shkresë përcjellëse. Vendimi i marrë dorazi është sekretuar në Prokurori me nr. 3769, datë 18.04.2019 dhe po atë ditë është nxjerrë urdhri i prokurorit nr. 229, datë 18.04.2019 për ekzekutimin e këtij vendimi. Për shkak të emergjencës, e gjithë praktika ekzistuese është dërguar me faks nga IT e Prokurorisë (Informacion dhe Teknologjia) në IEVP Fier, për të bërë lirimin e të dënuarit L.A..

Lidhur me faktin tjetër, që është konstatuar nga ana juaj dhe që lidhet me përgjegjësinë e organit të Prokurorisë për qëndrimin një ditë burg me shumë të të dënuarit L.A., sqarojmë se vendimi nr. 19, datë 27.02.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë është protokolluar në Prokurori në datën 17.04.2019 dhe ka ndjekur rrugën administrative brenda organit të Prokurorisë deri në mbërritjen dhe dorëzimin e këtij vendimi tek zyra e ekzekutimit të vendimeve penale në datën 18.04.2019.

Pra, sikurse cituam më lart, sapo kjo Gjykatë e ka dërguar vendimin penal nr. 19, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila e ka dorëzuar me vonesë dhe të pashoqëruar me vendimin nr. 507, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, menjëherë prokurori i ekzekutimeve e ka tërhequr dorazi nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë vendimin nr. 507, datë 19.11.2018, për të dënuarin L.A. dhe ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi.”

Në bazë të kërkesës tonë për dërgimin e një informacioni shtesë lidhur me shkaqet e dërgimit me vonesë, pas 1 (një) muaji e 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditëve, nga Kancelari i Gjykatës së Apelit Vlorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë të vendimit nr. 19, datë 27.02.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, Kryesekretaria e Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. 406 prot., datë 05.07.2019 na informoi se:

“Vendimi penal nr. 19, datë 27.02.2019, i dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, në ngarkim të të pandehurit L.A., është vënë në dispozicion të organeve kompetente për ekzekutimin e tij (Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) menjëherë pasi ne kemi rënë në dijeni të faktit se ky i fundit e kishte kryer dënimin e dhënë, duke theksuar se përlllogaritjen e kohëzgjatjes së dënimit nuk e kryen Gjykata.

Lidhur me mos dërgimin e dosjes penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ju sqarojmë se me ndryshimet në ligj, Gjykata e Apelit Vlorë kryen njoftimin e vendimit gjyqësor të gjitha palëve (në rastin konkret viktimave) që gjatë gjykimit në këtë gjykatë kanë qënë në mungesë, si dhe respekton afatet ligjore të përcaktuara në ligj, për pritjen e depozitimit të rekursit pranë kësaj Gjykate, procedurë e cila nuk ka përfunduar ende.”

Sqarojmë se, nga shkresa përcjellëse nr. 217 prot., datë 15.04.2019 e Kancelarit të Gjykatës së Apelit Vlorë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë rezulton se ju keni bërë kërkesë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Mirëpo ndonëse e kërkuam kopjen e kërkesës tuaj për shuarjen e dënimit bërë në Gjykatën e Apelit Vlorë, ajo nuk na u dërgua. Sidoqoftë, bërja e kërkesës nga ana juaj në Gjykatën e Apelit Vlorë për shuarjen e dënimit të dhënë, provon se kjo gjykatë është vënë në dijeni për faktin e shuarjes së dënimit tuaj dhe duhet të ishte treguar më e kujdeshme në trajtimin e këtij rasti.

Në përfundim të hetimit administrativ i kësaj ankese të kryer nga institucioni ynë kemi arritur në konkluzionin se ju jeni mbajtur në burg në mënyrë të paligjshme dhe tej masës së dënimit të dhënë nga Gjykatat me vendimet e cituara më sipër. Ju keni qëndruar në burg në mënyrë të padrejtë për 23 (njëzetë e tre) ditë duke ju cënuar të drejtën e lirisë të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës ku parashikohet se:

“Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.”

1. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

Gjithashtu kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 5/1 i Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili parashikon se:

“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka

motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një veprë penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

Gjithashtu juve ju është shkelur e drejta e garantuar nga neni 67, paragrafi i parë i ligjit nr. 8328, datë 18.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Lirimi i të dënuarve bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit”, si dhe nga neni 28 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur:

a) përfundon vuajtjen e dënimit;”

E drejta e lirisë tuaj është çenuar për shkak të pakujdesisë së treguar nga punonjësit e administratës së Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilët nuk e kanë vlerësuar me seriozitet rastin konkret dhe të dërgonin menjëherë në organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë vendimin penal nr. 19, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Justifikimi i bërë nga Kryesekretaria e Gjykatës së Apelit Vlorë se mos dërgimi i dosjes penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ardhur për shkak se, *me ndryshimet në ligj kjo Gjykatë kryen njoftimin e vendimit gjyqësor të gjitha palëve (në rastin konkret viktimave) që gjatë gjykimit në këtë Gjykatë kanë qënë në mungesë, si dhe respekton afatet ligjore të përcaktuara në ligj, për pritjen e depozitimit të rekursit pranë kësaj Gjykate*, nuk është i bazuar. Ne gjykojmë se në rastin konkret, dosja penale mund të mbahej në këtë Gjykatë me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale të përmenduar më sipër, ndërsa vendimi i dhënë prej saj ndaj jush duhet ti dërgohej menjëherë organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si organi kompetent për vënien e tij në ekzekutim. Përveç kësaj theksojmë se, njoftimi nga Gjykata i palëve që kanë qënë në mungesë apo edhe bërja e rekursit prej palëve në këtë proces nuk janë shkaqe ligjore që e pezullojnë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë.

Ndërkohë gjykojmë se edhe organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë duhet të ishte treguar më i përgjegjshëm në këtë rast. Nga ky organ është nxjerrë urdhri i lirimit tuaj nga burgu, një ditë pasi i ka ardhur vendimi nga Gjykata e Apelit Vlorë, duke ju lënë edhe një ditë më shumë padrejtësisht në burg. Neglizhenca e këtij organi konstatohet edhe lidhur me faktin tjetër se, ndonëse ka konstatuar shkeljen e të drejtës tuaj kushtetuese, nuk ka bërë asnjë lloj reagimi zyrtar ndaj pakujdesisë së treguar nga punonjësit e administratës së Gjykatës së Apelit Vlorë.

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të organeve gjyqësore dhe të prokurorisë, si dhe rritjen e besimit të publikut tek këto organe, i rekomanduam Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë si më poshtë:

“1. Analizimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse, nxjerrjen e përgjegjësive ligjore dhe dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

2. Përgjithësimin e këtij rasti në organet gjyqësore, të prokurorisë dhe në IEVP në shkallë vendi me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen të shkeljeve të kësaj natyre të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të burgosur.”

Ndërkohë këtë rekomandim ia dërguam për dijeni Ministrisë së Drejtësisë.

Përveç këtij reagimi të bërë nga institucioni ynë, për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtës tuaj të shkelur, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se:

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “e” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:
e. u rekomandon personave të dëmtuar të paraqesin padi në gjykatë;”*

REKOMANDOJMË

Që ti drejtoheni me kërkesë padi Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për të kërkuar kompensim për burgim të padrejtë për 23 ditë, në bazë të neneve 268 dhe 269 të Kodit të Procedurës Penale.

Për të realizuar këtë të drejtë ligjore në rrugë gjyqësore, ju sugjerojmë që të konsultoheni me një avokat.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi